



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

05 mars 2014

Duke u bazuar në nenin 4 (3), në nenin 83 dhe në nenin 84 (1), (2) dhe (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Dekretit DKMDHS-001-2014, Presidentja e Republikës së Kosovës, më datën 05 mars 2014 miratoi :

**RREGULLAT E PROCEDURËS
PËR
KËSHILLIN KOMBËTAR PËR TË MBIJETUARIT E DHUNËS SEKSUALE
GJATË LUFTËS**

1. Dispozitat e përgjithshme

Rregullat e Procedurës për Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) përcaktojnë qëllimin, synimin, funksionet, përbërjen dhe mënyrën e punës së Këshillit.

2. Qëllimi

Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës është trup koordinues nën udhëheqjen e Presidentes së Republikës së Kosovës.

Në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, Këshilli ka për qëllim bashkërendimin e punës dhe të aktiviteteve të institucioneve e agjencive, në kuadër të kompetencave dhe të fushëveprimit të tyre për të rehabilituar të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës.

3. Funksionet e Këshillit

3.1 Këshilli nxjerr raporte të rregullta për punën dhe aktivitetin e vet.

3.2. Këshilli ka këto funksione:

1. Koordinimi i aktiviteteve për statusin dhe çështjet e tjera të të mbijetuarëve të dhunës seksuale gjatë luftës;
2. Identifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve në përkrahje të të mbijetuarëve të dhunës seksuale gjatë luftës;
3. Përcaktimi i prioriteteve dhe politikave për zbatimin e agjendës legislative në përkrahje të të mbijetuarëve të dhunës seksuale gjatë luftës;
4. Koordinimi i punës dhe aktiviteteve të institucioneve përgjegjëse në forcimin e mekanizmave ekzistues për përkrahje të të mbijetuarëve të dhunës seksuale gjatë luftës;
5. Rritja e vetëdijes së shoqërisë për të mbijetuarit të dhunës seksuale gjatë luftës;

4. Përbërja e Këshillit

4.1 Këshilli ka këtë përbërje:

4.1.1 Udhëheqëse – Presidentja e Republikës së Kosovës;

4.1.2 Anëtarë të Këshillit janë:

- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale
- Ministria e Integritit Evropian
- Ministria e Brendshme
- Agjensia për Barazi Gjinore
- Komisioni Parlamentar për Legjislacion
- Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
- Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
- Komisionin Parlamentar për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim
- Grupi i Grave Deputete
- Policia e Kosoves
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës

- Këshilli Prokurorial i Kosovës
- EULEX
- Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNJ)
- Ombudsperson
- Përfaqësuesit e Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës
- Përfaqësuesit e shoqërisë civile të fushës

4.2 Anëtarët e Këshillit marrin pjesë në takime dhe kontribuojnë në punën e në diskutimet e Këshillit.

4.3 Bazuar në agjendën e mbledhjes, Udhëheqësja mund të ftojë përfaqësues të institucioneve tjera, shoqërisë civile dhe misionet ndërkombëtare të marrin pjesë në mbledhjen e Këshillit.

4.4 Udhëheqësja fton pjesëmarrësit jo-anëtarë për të dhënë kontribut sipas nevojës në përputhje me përvojën e tyre në këtë fushë.

4.5 Udhëheqësja i thërret mbledhjet e Këshillit dhe përcakton agjendën e takimeve. Varësisht nga agenda takimet do të mbahen të hapura ose të mbyllura.

5. Takimet e Këshillit

5.1 Takimet e Këshillit do të mbahen së paku tre herë në vit.

5.2 Takimet e Këshillit thirren nga Udhëheqësja e Këshillit.

5.3 Anëtarët e Këshillit mund t'i propozojnë me shkrim Udhëheqëses së Këshillit mbledhjen e Këshillit jo më pak se 15 ditë pune para mbajtjes së takimit.

6. Përgatitja dhe mbajtja e takimeve

6.1 Udhëheqësja thërret takimin e Këshillit, jo më vonë se 7 ditë pune para mbajtjes së takimit.

6.2 Anëtarët e Këshillit mund t'i propozojnë Udhëheqëses pika të veçanta të rendit të ditës, jo më vonë se 10 ditë pune para mbajtjes së takimit.

6.3 Udhëheqësja mund të thërrasë takime edhe në afat më të shkurtër, sipas nevojës.

6.4 Të gjitha materialet për takimet e Këshillit do të përgatiten dhe shpërndahen nga Sekretariati.

7. Mbajtja e takimeve dhe përfundimet

7.1 Takimet e Këshillit drejtohen nga Udhëheqësja e cila kujdeset për rendin e folësve, kohëzgjatjen e fjalës dhe mbarëvajtjen e diskutimeve.

7.2 Sekretariati mban procesverbalet e të gjitha takimeve dhe materialet e tjera të takimeve dhe bën shpërndarjen e tyre.

7.3 Të gjitha procesverbalet dhe materialet tjera të takimeve dhe punës së Këshillit ruhen nga Sekretariati.

8. Rekomandimet e Këshillit

8.1 Presidentja lëshon rekomandime për hapat e mëtejshëm pas çdo takimi të Këshillit, bazuar në diskutimet e bëra.

9. Sekretariati

9.1 Sekretariati i Këshillit do të veprojë në kuadër të Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës. Sekretariati i Këshillit do të jetë përgjegjës për organizimin e punës së Këshillit.

9.2 Sekretariati do të kryejë këto detyra:

- Të përgatisë dhe të shpërndajë rendin e ditës së takimeve, sipas udhëzimeve të Udhëheqëses;
- Të organizojë takimet;
- Të sigurojë ndihmë teknike gjatë takimeve;
- Të përgatisë procesverbalet e takimeve;
- T'u shpërndajë të gjithë pjesëmarrëseve materialet e takimeve;
- Të mbajë arkivin e materialeve të takimeve;
- Të ndërmarrë dhe të koordinojë detyra tjera të cilat i ngarkohen.

10. Dispozitat përfundimtare

Këto rregulla të procedurës hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Udhëheqësja e Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës


Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës